



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Prishtinë, datë, 09.08.2019

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, duke marrë parasysh nenin 38 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Administratën Shtetërore të republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe 6) të Rregullores Nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, shtojcën 21 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2011, Rregulloren Nr. 14/2017 dhe Rregulloren Nr. 15/2017, Ligjin Nr. 06/L - 133 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, si dhe neni 12 i Rregullores 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit të OJQ-vë, nxjerrë;

V E N D I M

Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekte/programme të organizatave jo-qeveritare në fushën e zhvillimit socio - ekonomik rajonal të balancuar.

I

1. Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF - Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
2. Mbështetja financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i MZHR-së, kodi ekonomik 221/në kuadër të programit Subvencione dhe transfere.

II

1. Mjetet e përmendura në nenin 2 do të shpërndahen në bazë thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II. të këtij vendimi përfshinë:
 1. Teksti i thirrjes publike
 2. Udhëzimet për aplikantët
 3. Formularët e aplikimit
 4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
 5. Format për raportimin e zbatimit të projektit
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
 2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
 3. Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta

4. Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikueshme)
 5. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike.
 6. Deklarata për Aktivitetet e kontraktori e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet).
3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
 2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
 3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit

IV.

1. Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të MZHR-së: <https://mzhr.rks-gov.net/language/sq/>

V.


1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, MZHR do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren për financimin publik të OJQ-ve.

VI.

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, Udhëheqësi i institucionit do të nxjerr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve.
2. MZHR do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Departamenti për Zhvillim Rajonal.

VII.

Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit.

Fatos Qerimi

Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Zhvillimit Rajonal

Në kopje:

- Rasim Demiri, Minister i MZHR-së;